



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 51, datë 06.07.2016

**Për**

**“MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME ENFITEOZË TË OBJEKTIT “REPARTI I GALANTERISË ” ME SIPËRFAQE TOTALE 2766.5 M<sup>2</sup> NJËSI E NDËRMARRJES METALIKE “TIRANA”.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b” dhe pika 1/1.2, nenit 36, pika 2, nenit 54, pika “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”; ligjit nr.7582, datë 13.07.1992 për “Ndërmarrjet shtetërore” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 378, datë 12.08.1999 për “Kalimin e të drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 për “Përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (i ndryshuar); udhëzimit nr.6, datë 03.09.1992 për “Zbatimin e ligjit nr.7582, datë 13.07.1992 për “Ndërmarrjet shtetërore”; udhëzimit Nr. 6756, datë 03.09.2015 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; kërkesës të Ndërmarrjes Metalike “Tirana” për dhënie me enfiteozë të objektit “Reparti i Galanterisë”, propozimit të ndërmarrjes Metalike “Tirana” miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues, Nr.1, datë 16.05.2016, memos së Kryetarit nr 12677/2, datë 24.05.2016, propozimit të Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licencimit dhe Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë në parim dhënien me enfiteozë të objektit “Reparti i Galanterisë”, me sipërfaqe totale 2766.5 m<sup>2</sup>, sipërfaqja ndërtesë 1729.5 m<sup>2</sup>, sipërfaqja funksionale 1037 m<sup>2</sup>, njësi e Ndërmarrjes Metalike “Tirana” me vlerë kontabël 30.965.440 lekë.
2. Afati i dhënies me enfiteozë të jetë për një periudhë 20 vjeçare.
3. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurimit publik dhe elementëve të tij, në mbështetje të VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014 për “Përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (i ndryshuar).

4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës për lidhjen e kontratës së enfiteozës pas përfundimit të procedurave të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Ndërmarrja Metalike “Tirana” dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**

